

“Horizon Shpk”

Pasqyrat Financiare

për ushtrimin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

A handwritten signature or mark consisting of several overlapping, dark lines, possibly representing a stylized letter or a signature.

PERMBAJTJA:

RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR	1,11
PASQYRA E GJENDJES FINANCIARE	1
PASQYRA E TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE	2
PASQYRA E FLUKSIT TE MJETEVE MONETARE	3
PASQYRA E LEVIZJEVE NE KAPITAL	4
1. Informacion i pergjithshem	5
2. Permbledhje e politikave te rendesishme kontabile	5
3. Aktive afatgjate materiale	8
4. Kerkesa tregtare dhe te tjera te arketueshme	8
5. Parapagime dhe shpenzimet e shtyra	9
6. tatim fitimi i parapaguar	9
7. Mjete monetare dhe ekuivalente me to	9
8. Kapitali i nenshkruar	9
9. Furnitore dhe detyrime te tjera	10
10. Detyrime ndaj paleve te lidhura	10
11. Kredi afatshkurter/ overdraft	10
12. Provizione per shpenzime	10
13. Te ardhurat	11
14. Shpenzime personeli	11
15. Shpenzime te pergjithshme administrative	11
16. Tatim fitimi	12
17. Ngjarje te tjera pas dates bilancit	12





BAKER TILLY ALBANIA

Rr. Themistokli Germenji,
No.2, Ambasador 1, 3-rd floor,
Tirana, Albania.
Tel: +355 4 223 2726
www.bakertillyalbania.com

RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR

Raport mbi Pasqyrat Financiare

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkëngjitur të Horizon Shpk. që përfshijnë pasqyrën e gjëndjes financiare më 31 Dhjetor 2013, pasqyrën e të ardhurave e shpenzimeve, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë si dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabile dhe shënime të tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi i Shoqërisë është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit miratuar me Ligjin Nr.9228 datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”. Kjo përgjegjësi përfshin: hartimin, zbatimin dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare pa gabime materiale, qoftë nga mashtrime apo pasaktësira; përzgjedhjen dhe aplikimin e politikave të duhura kontabël dhe bërjen e vlerësimeve kontabël që janë të përshtatshme për rrethanat.

Përgjegjësia e Audituesit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar mbi auditimin tonë. Ne kryem auditimin tonë në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarte kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin me qëllim që të përftojme siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk kanë gabime materiale.

Auditimi përfshin procedurë për të marrë evidencë auditimi për vlerat dhe paraqitjet në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë dhe vlerësimin e riskut të egzistencës së gabimeve materiale në pasqyrat financiare, qofshin rezultat i mashtrimeve apo pasaktësira. Në bërjen e këtyre vlerësimeve, audituesi konsideron kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të shoqërisë. Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin për përshtatshmërinë e parimeve kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kryesore të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se evidencat e auditimit që kemi marrë ofrojnë baza të arsyeshme për dhënien e opinionit të auditimit.

Arsyet per Opinion me Rezerva

Ne nuk kemi marrë pjesë në numërimin e inventarit në 31 Dhjetor 2013 sepse kemi qenë të angazhuar si auditues të shoqërisë vetëm pas kësaj date dhe ne nuk mund të merrnim siguri me procedura të tjera auditimi per inventarin ne ate date. Gjithashtu ne nuk mundem te merrnim konfirmime direkte nga disa furnitore te huaj te shoqerise ose te merrnim siguri me procedura te tjera auditimi per keto detyrime ne daten 31 Dhjetor 2013. Rrjedhimisht, ne e kishim te pamundur te percaktonim nëse ndonje korrigjim mund të ishte i nevojshem.

Opinion me Rezerva

Sipas opinionit tone, pervec efektit te atyre korrigjimeve, nese ka ndonje, qe mund te ishin percakruar si te nevojshem nese ne do te merrnim evidencen e duhur te auditimit sic eshte pershkruar ne paragrafin Arsyet per Opinion me Rezerva, pasqyrat financiare paraqesin ne menyre te sinqerte ne te gjitha aspektet materiale gjendjen financiare te Horizon shpk me 31 Dhjetor 2013, te rezultatit te saj financiar dhe te flukseve te saj te parave ne fund te vitit te mbyllur ne kete date ne perputhje me Standardet Kombetare te Kontabilitetit dhe me Ligjin Nr.9228 date 29.04.2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare".

Baker Tilly Albania shpk

Elton Haxhi
Ekspert Kontabel i Regjistruar

BAKER TILLY ALBANIA
SHPK
K91721010Q

Tiranë
24 Qershor 2014


PASQYRA E GJENDJES FINANCIARE

(Gjithe vlerat ne Leke)

	Shenime	Ne 31 Dhjetor	
		2013	2012
AKTIVET			
Aktive afatgjata materiale	3	4.446.679	5.010.335
Totali i aktiveve afatgjata		4.446.679	5.010.335
Inventari		50.573.172	27.742.013
Kerkesa tregtare dhe te tjera te arketueshme	4	85.494.478	86.120.221
Parapagime dhe shpenzimet e shtyra	5	2.475.739	1.893.765
Tatim fitimi i parapaguar	6	72.665	6.454.196
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	7	42.799.491	25.657.555
Totali i aktiveve afatshkurtra		181.415.545	147.867.750
Totali i aktiveve		185.862.224	152.878.085
KAPITALET E VETA			
Kapitali i nenshkruar	8	500.000	500.000
Rezerva ligjore		50.000	50.000
Fitime te mbartura		54.018.842	16.887.924
Totali i kapitaleve te veta		54.568.842	17.437.924
DETYRIMET			
Furnitore dhe detyrime te tjera	9	99.279.227	54.462.571
Detyrime ndaj paleve te lidhura	10	32.000.000	32.000.000
Kredi afatshkurter/ overdraft	11	14.155	48.149.644
Provizione per shpenzime	12	-	827.946
Totali i detyrimeve		131.293.382	135.440.161
Totali i detyrimeve dhe kapitaleve te veta		185.862.224	152.878.085

Pasqyrat financiare dhe shenimet shpjeguese nga faqja 1 deri 12 jane firmosur dhe miratuar me 29 Mars 2014 nga:

Administratori
Theodoros Stachos

Shefe Finance
Glediana Nakuci



PASQYRA E TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE*(Gjithe vlerat ne Leke)*

	Shenime	Viti i mbyllur ne 31 Dhjetor	
		2013	2012
Te ardhurat	13	221.201.333	230.391.207
Shpenzime per materiale		(86.931.561)	(107.914.180)
Shpenzime per konsulenca		(36.869.482)	(39.080.682)
Shpenzime personeli	14	(32.675.640)	(37.378.598)
Shpenzime te pergjithshme dhe administrative	15	(21.097.517)	(26.846.867)
Provizion per shpenzime tatimore	12	-	(827.946)
Amortizimi i aktiveve afatgjata materiale	3	(1.254.536)	(1.435.420)
Rezultati nga veprimtaria		42.372.597	16.907.514
Te ardhura te tjera		411.026	
Fitime/ (humbje) nga kembimet valutore		(1.126.777)	2.603.536
Te ardhura/ (shpenzime) financiare neto			
Fitimi para tatimit		41.656.846	19.511.050
Tatimi mbi fitimin	16	(4.525.928)	(2.623.126)
Fitimi neto per periudhen		37.130.918	16.887.924

PASQYRA E FLUKSIT TE MJETEVE MONETARE

(Gjithe vlerat ne Leke)

Shenime	Viti i mbyllur 31 Dhjetor	
	2013	2012
Flukse monetare nga veprimtaria		
Fitimi para tatimit	41.656.846	19.511.050
<i>Rregullime per:</i>		
Amortizimin	3	1.254.536
Provizion	--	827.946
Fitimi nga veprimtarite para ndryshimeve ne kapitalin punues	42.911.382	21.774.416
(Rritja)/zvogelim e kerkesave per arketim	3.023.952	27.192.492
(Rritja)/zvogelim ne inventar	(22.831.158)	9.746.058
Rritja/(zvogelim) e llogarive te pagueshme	43.988.710	(54.060.031)
Tatim fitimi i paguar	6	(1.124.580)
Mjete monetare neto nga veprimtarite e shfrytezimit	65.968.306	1.278.368
Flukse monetare nga veprimtarite investuese		
Kredi nga aksioneri	--	32.000.000
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	(690.881)	(1.264.604)
Mjete monetare perdorur ne veprimtarite investuese	(690.881)	30.735.396
Flukse monetare nga veprimtarite financuese		
Dividende te paguar		(27.749.555)
Short term loan	(48.135.489)	14.346.129
Mjete monetare perdorur ne veprimtarite financuese	(48.135.489)	(13.403.426)
Rritja neto e mjeteve monetare	17.141.936	18.610.337
Mjete monetare ne fillim te vitit	4	25.657.554
Mjete monetare ne fund te vitit	4	42.799.491
		25.657.554

PASQYRA E LEVIZJEVE NE KAPITAL*(Gjithe vlerat ne Leke)*

	Kapitali themeltar	Rezerva ligjore	Fitime te mbartura	Totali
Gjendja me 31 Dhjetor 2011	500.000	50.000	27.749.555	28.299.555
Fitimi i vitit 2012	-	-	16.887.924	16.887.924
Dividende te paguar	-	-	(27.749.555)	(27.749.555)
Gjendja me 31 Dhjetor 2012	500.000	50.000	16.887.924	17.437.924
Fitimi i vitit 2013	-	-	37.130.918	37.130.918
Dividende te paguar	-	-	-	-
Gjendja me 31 Dhjetor 2013	500.000	50.000	54.018.842	54.568.842

1. INFORMACION I PERGJITHSHEM

Shoqeria "Horizon" Shpk. (me poshte "Shoqeria") eshte krijuar si shoqeri me pergjegjesi te kufizuar ne date 23/09/2005.

Objekti kryesor i veprimtarise se shoqerise perfshin veprimtari ne fushen e teknologjise, duke ofruar krijimin dhe integrimin te sistemeve te informacionit per shoqeri dhe individ, import, eksport si dhe shitje te pajisjeve informatike, produkteve hardware dhe software dhe programe ne tregun vendas dhe ate te huaj.

Me 31 Dhjetor 2013 shoqeria kishte 17 te punesuar (31 Dhjetor 2012 : 17 punonjes). Adresa e shoqerise eshte rruga "Ibrahim Rugove", pallati Green Park, Nr 42, kulla 2, kati 2. Shoqeria eshte regjistruar si tatimpagues ne rrethin e Tiranës me NIPT K52225004V.

Pasqyrat financiare te shoqerise per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013 jane miratuar nga Administratori i shoqerise me 29 Mars 2014.

2. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE TE RENDESISHME KONTABILE

a. Bazat e pergatitjes se pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare jane pergatitur, ne te gjithe aspektet materiale, ne perputhje me Standartet Kombetare te Kontabilitetit (SKK), te cilat perbehen nga rregullat dhe interpretimet ne perputhje me Ligjin nr.9228 date 29.04.2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare".

Pasqyrat financiare jane pergatitur mbi bazen e kosos historike. Te dhenat aktuale dhe krahasuese jane prezantuar ne Lek Shqiptare (LEK), qe eshte monedha raportuese e shoqerise.

b. Aktivet afatgjata materiale dhe jomateriale

(i) Njohja dhe matja

Te gjitha aktivet afat-gjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvleresimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja perfshin shpenzime te cilat lidhen drejtperdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve te vetë-ndërtuara perfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjëndje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes si në gjëndjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktiviteti afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentet më të mëdhenj) të aktiveve afat-gjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur, dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave.

(ii) Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afat-gjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

**2. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE TE RENDESISHME KONTABILE
(VAZHDIM)****b. Aktivet afatgjata materiale dhe jomateriale (vazhdim)***(iii) Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën lineare apo zbritëse të amortizimit, mbi jeten e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit. Toka nuk amortizohet.

Norma e amortizimit per periudhën aktuale jane si më poshtë:

Kategoria	Metoda e amortizimit	Norma e amortizimit
Instalime teknike	Mbi vlerën kontabël neto	5%
Mobilje dhe paisje zyre	Mbi vlerën kontabël neto	20%
Pajisje informatike	Mbi vlerën kontabël neto	25%
Të tjera	Mbi vlerën kontabël neto	20%

Aktivitetet afatgjata jomateriale njihen atëherë kur është e mundur që të përfitime ekonomike do të sigurohen në të ardhmen në lidhje me këto aktive dhe kostojat e tyre mund të matet në mënyrë të besueshme.

c. Inventari

Inventaret janë paraqitur në pasqyrat financiare të Shoqërisë duke përdorur vlerën e blerjes së tyre që është më e vogël se vlera neto e realizueshme. Për inventarizim shoqëria ka përdorur metodën periodike dhe për vlerësimin ka përdorur metodën e kostos mesatare.

d. Llogaritë e arketueshme dhe llogaritë të pagueshme

Llogaritë e arketueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me koston të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arketueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Veshitësitë financiare të debitorit, mundësia që debitorit të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arketueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me koston të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

e. Paraja dhe ekuivalentet e parasë

Paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat në Lek dhe në monedha të huaja. Për qëllimin e pasqyrës së flukseve monetare, paraja dhe ekuivalentet e saj përfshijnë depozitën pa afat ose me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

f. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Asetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit.

2. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE TE RENDESISHIME KONTABILE (VAZHIDIM)**f. Transaksionet ne monedhe te huaj (vazhdim)**

Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare si dhe parapagimet në lidhje me LAM për t'u blerë në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset zyrtare të këmbimit për monedhat kryesore të përdorura në konvertimin e zërave të bilancit në monedhë të huaj ishin si më poshtë (në Lek):

	<u>31 Dhjetor 2013</u>	<u>31 Dhjetor 2012</u>
1 EUR	140,20	139,59
1 USD	101,86	105,85

g. Njohja e te ardhurave

Të ardhurat njihen në masën që është e mundshme që përfitimet e ardhshme ekonomike do ti vijnë kompanisë dhe këto përfitime mund të maten në mënyrë të besueshme. Shpenzimet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur ato kryhen. Të ardhurat dhe shpenzimet regjistrohen në pasqyrat financiare të periudhës të cilës i përkasin.

h. Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin është llogaritur në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi për tatimin mbi fitimin për periudhën e mbyllur më 31 Dhjetor 2013. Tatimi mbi fitimin përfshin tërësisht tatimin mbi fitimin e llogaritur për periudhën kontabël. Tatimi aktual mbi fitimin llogaritet si 10% e fitimit të tatueshëm të përcaktuar në legjislacionin e kontabilitetit dhe legjislacionin tatimor në Shqipëri për vitin 2013 (2012: 10%).

i. Fondet per pensione

Shoqëria paguan kontributet për pensione si edhe kontribute për sigurim shëndetsor për punonjësit e saj sic është parashikuar nga legjislacioni social vendas. Kontributet, bazuar në pagat, janë paguar në llogari të organizmave kombëtare përgjegjës për pagesën e pensioneve dhe shpenzimeve shëndetsore. Nuk ka asnjë detyrim tjetër në lidhje me fondin për pensione dhe shpenzime shëndetsore.

j. Krahasueshmëria

Informacioni krahasues paraqitet në mënyrë të vazhdueshme, duke aplikuar politikat kontabël të Shoqërisë dhe duke u bazuar në modelin e pasqyrave financiare sipas sistemit kontabël Shqiptar.

k. Biznesi ne vijimesi

Te dhenat e kontabilitetit janë mbajtur duke qenë në përputhje me parimet e përgjithshme të kontabilitetit, në mënyrë të vecante me bazën e matjes me kosto historike, parimin e kontabilitetit rrjedhës, konceptin e kujdesit dhe me supozimin e biznesit në vijimesi. Pasqyrat financiare janë përgatitur sipas parimit të vijimesisë, i cili parashikon realizimin e aktiveve dhe shlyerjen e detyrimeve gjatë ecuresë normale të biznesit.

Horizon Shpk**Shenime te pasqyrave financiare****Per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013****3. AKTIVE AFATGJATE MATERIALE**

	Pajisje informatike	Pajisje zyre	Te tjera	Totali
Kosto				
Me 31 Dhjetor 2011	8.422.516	3.196.153	399.301	12.017.970
Shtesa	781.480	451.624	31.500	1.264.604
Me 31 Dhjetor 2012	9.203.996	3.647.777	430.801	13.282.574
Shtesa	613.056	43.750	34.075	690.881
Me 31 Dhjetor 2013	9.817.052	3.691.527	464.876	13.973.455
Amortizimi i akumuluar				
Me 31 Dhjetor 2011	(4.374.445)	(2.312.893)	(149.482)	(6.836.820)
Amortizimi per vitin	(1.160.590)	(224.866)	(49.964)	(1.435.420)
Me 31 Dhjetor 2012	(5.535.035)	(2.537.759)	(199.446)	(8.272.240)
Amortizimi per vitin	(977.716)	(233.769)	(43.051)	(1.254.536)
Me 31 Dhjetor 2013	(6.512.751)	(2.771.528)	(242.497)	(9.526.776)
Vlera kontabel neto:				
Me 31 Dhjetor 2011	4.048.071	883.260	249.820	5.181.150
Me 31 Dhjetor 2012	3.668.960	1.110.019	231.356	5.010.335
Me 31 Dhjetor 2013	3.304.301	919.999	222.379	4.446.679

4. KERKESA TREGETARE DHE TE TJERA TE ARKETUESHME

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Kerkesa per arketim	81.823.284	86.120.221
TVSH e arketueshme, neto	1.446.459	-
Te tjera te arketueshme	2.224.735	-
Totali	85.494.478	86.120.221

PARAPAGIM/ (DETYRIM) PER TVSH

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
TVSH e pagueshme mbartur nga viti paraardhes	(1.994.543)	(2.454.035)
TVSH e llogaritur (rubrika 12)	(46.363.338)	(52.297.938)
TVSH i zbritshem blerje (rubrika 17)	30.528.189	28.771.074
TVSH e paguar gjate vitit ushtrimor	19.276.151	23.986.356
Parapagim / (Detyrim) per TVSH	1.446.459	(1.994.543)

Horizon Shpk**Shenime te pasqyrave financiare****Per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013****5. PARAPAGIME DHE SHPENZIMET E SHTYRA**

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Paradhenie per punonjesit	-	694.882
Shpenzime te periudhave te ardhme	2.475.739	1.198.883
Totali	2.475.739	1.893.765

6. TATIM FITIMI I PARAPAGUAR

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Gjendje ne fillim	6.454.196	6.764.534
Paguar gjate vitit	1.124.580	3.374.567
Korrigjime te viteve te meparshme	(1.183.935)	-
Kompesuar me detyrime nga akt kontolli	(1.796.248)	(1.061.779)
Tatim fitimi i vitit ushtrimor	(4.525.928)	(2.623.126)
Parapagim/(Detyrim) ne fund	72.665	6.454.196

7. MJETE MONETARE DHE EKVIVALENTE ME TO

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Vlera në arkë	32.828	2.782
<i>Vlera në banka</i>	<i>42.766.663</i>	<i>25.654.773</i>
Ne Lek	15.322.323	8.462.663
Ne Euro	27.391.573	11.346.504
Ne USD	52.768	5.845.606
Totali	42.799.491	25.657.555

8. KAPITALI I NENSHKRUAR

Kapitali i nenshkruar dhe struktura aksionare me 31 Dhjetor 2013 dhe 2012 paraqiten si me poshte:

	31 Dhjetor 2013		31 Dhjetor 2012	
	Ne %	Ne Vlere	Ne %	Ne Vlere
Theodoros Stachos	100%	500.000	100%	500.000
	100%	500.000	100%	500.000

Duke u bazuar ne vendimin e ortakeve ne 1 Tetor 2012 dhe regjistruar ne QKR ne 24 Tetor 2012 ortaku i vetem i transferoi 100% te kuotave Theodoros Stachos . Ne 31 Dhjetor 2013 kapitali akionar perbehej nga 5.000 kuota me vlere nominale 100 Lek/ secili (2012: 5.000 kuota me vlere nominale 100 Lek/ secili).

Horizon Shpk**Shenime te pasqyrave financiare****Per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013****9. FURNITORE DHE DETYRIME TE TJERA**

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Furnitore	86.064.016	44.507.744
TVSH e pagueshme neto	-	1.994.543
Paga te pagueshme	103.850	-
Taksa dhe tatime te tjera	672.260	571.934
Dividende te pagueshem	4.130.839	4.130.839
Te ardhura te periudhave te ardhme	7.012.856	1.976.343
Shpenzime te perlogaritura	1.207.824	1.148.428
Detyrime te tjera	87.582	132.739
Totali	99.279.227	54.462.570

10. DETYRIME NDAJ PALEVE TE LIDHURA

Ne detyrime ndaj paleve te lidhura eshte perfshire nje kredi nga ortakut i vetem Theodoros Stachos ne 12 Dhjetor 2013. Shuma nuk mbart interesa dhe nuk ka date te percaktuar te shlyerjes.

11. KREDI AFATSHKURTER/ OVERDRAFT

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
E pagueshme deri ne 08/06 vitin e ardhshem	14.155	20.936.543
E pagueshme deri ne 09/08 vitin e ardhshem	-	13.254.431
E pagueshme deri ne 30/10 vitin e ardhshem	-	13.958.671
Totali	14.155	48.149.644

12. PROVIZIONE PER SHPENZIME

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Ne 1 Janar	827.946	-
Perdorur gjate vitit per penalitete e gjoba	(790.609)	-
Kaluar si e ardhur gjate vitit	(37.337)	-
Porvizione per rreziqe e shpenzime	-	-
-Shtesa per ceshtje tatimore	-	827.946
Ne 31 Dhjetor	-	827.946

Provizionet per ceshtje tatimore perfaqesojne parashikimet e drejtimit per pagesen e gjobave dhe kamatvonesave sipas njoftim vleresimit tatimor ne Prill 2012.

Horizon Shpk**Shenime te pasqyrave financiare****Per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013****13. TE ARDHURAT**

	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2013	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2012
Te ardhura nga shitje sherbime	142.606.456	146.810.478
Te ardhura nga shitje mallra	78.594.877	83.580.730
Totali	221.201.333	230.391.207

Ne shifren e afarizimit dhe TVShn e llogaritur ne blerje dhe shitje sipas sistemit tatimor eshte perfshire edhe vlera e tatueshme Lek 22.642.019(Lek 29.983.214 ne 2012) per autofaturimet sipas nenit 15, pika 5 te ligjit 7928 per "Tatimin mbli Vleren e Shtuar" e cila nuk perfaqeson nje te ardhur per shoqerine.

14. SHPENZIME PERSONELI

	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2013	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2012
Pagat	30.215.672	34.913.892
Sigurimet shoqerore	2.459.968	2.464.706
Totali	32.675.640	37.378.598

15. SHPENZIME TE PERGJITHSHME ADMINISTRATIVE

	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2013	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2012
Qira	6.460.965	7.902.960
Sherbime profesionale	332.036	1.782.671
Udhetime dhe dieta	1.244.721	1.367.572
Karburant	1.464.350	1.356.650
Uje, drita	460.893	62.922
Postare dhe komunikimi	2.946.847	4.171.702
Gjoha dhe demshperblime	3.112.255	2.418.170
Shpenzime te tjera operative	5.075.450	7.784.220
Totali	21.097.517	26.846.867

Horizon Shpk
Shenime te pasqyrave financiare
Per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013

16. TATIM FITIMI

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Fitimi para tatimit	41.656.846	19.511.050
Te ardhura te patatueshme	(37.337)	
<i>Efekti tatimor i shpenzimeve qe nuk jane te zbritshme per qellime tatimore</i>		
Shpenzime per pritje dhe perfaqesime mbi kufirin tatimor	-	-
Gjoha dhe demshperblime	1.014.028	2.418.170
Provizione		827.946
Shpenzime pa dokumentacion te rregullt	608.944	1.874.627
Te tjera fatura		816.516
Shpenzime marketingu	610.864	
Shpenzime te tjera	1.405.934	782.950
Fitimi I tatueshem	45.259.279	26.231.259
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	4.525.928	2.623.126

17. NGJARJE TE TJERA PAS DATES BILANCIT

Nuk ka asnje ngjarje te rendesishme pas mbylljes se vitit ushtrimor qe te kerkoje korrigjime apo pershkrime ne keto pasqyra financiare.